

## **Hapet thirrja për aplikime për bursa për stafin akademik dhe administrativ të Universitetit të Tiranës, në kuadër të Programit Erasmus +, në Universitetin e Anadoll-it, Turqi.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik dhe administrativ të Universitetit të Tiranës , në Universitetin e Anadoll-it, në Turqi.

### **Llojet e mobilitetit /kohëzgjatja:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për trajnim/5 ditë+2 ditët e udhëtimit;
- Shkëmbimin e stafit administrativ për trajnim/ 5 ditë+2 ditët e udhëtimit;

Linku për Universitetin e Anadoll-it: <http://anadolu.edu.tr/en>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor për stafin (140 EUR në ditë);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik/administrativ për trajnim:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër mbi qëllimin e vizitës së mobilitetit (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Plani i mobilitetit për trajnim\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:  
[http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training\\_Mobility\\_Plan.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf)

\*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

**Afati për aplikim:** 22 Dhjetor 2017

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)  
Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!